



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEQA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 05 / 2489 Dt. 24 / 11 / 2023

Në mbështetje të Rregullores për Veprimtari kërkimore-shkencore në UKZ, nr. 02/804 të datës 12.05.2022, publikohet:

Thirrje

Për aplikim të stafit akademik të UKZ-së për mbështetje financiare të publikimeve shkencore 2023

UKZ ka krijuar kushte për veprimtari kërkimore-shkencore, duke ndihmuar stafin akademik edhe financiarisht që të arrijë rezultate konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ftohen të gjithë anëtarët e stafit akademik që kanë publikuar punime shkencore në emër të UKZ, me simbolet dhe adresat e komunikimit zyrtar të UKZ, të aplikojnë për mbështetje financiare nga buxheti për kërkime dhe hulumtime shkencore, të publikuara gjatë vitit 2023.

Publikimet shkencore të publikuara nga data 04.12.2022, do të financohen bazuar në Rregulloren nr. 02/804 të datës 12.05.2022.

Për të fituar të drejtën për mbështetje financiare, personeli akademik duhet të argumentojë si vijon:

1. Kërkesën, me të dhënat e plota të autorit/autorëve, të protokolluara dhe të dërguara në e mail: info@uni-gjilan.net
 - Titulli i punimit (në gjuhën e publikuar në revista shkencore),
 - linkun e revistës ku është publikuar punimi,
 - Platforma e indeksimit të revistës,
 - linku ku është indeksuar punimi.
2. Artikulli me tekst të plotë, që bartin adresën e UKZ-së të botuara në revista shkencore të mbuluara nga Clarivate Analytics – Web of Science (grupi: SCIE, SSCI, dhe AHCI)
3. Artikuj me tekst të plotë që bartin adresën e UKZ-së, të botuara në revista shkencore të indeksuara në SCOPUS (grupi: Q1, Q2, Q3 dhe Q4.)

Thirrja publikohet në web - faqen e UKZ dhe është e hapur prej datës 24.11.2023 deri më datën 03.12.2023.



Prof. Ass. Dr. Arbona Xhemajli
Prorektore për Hulumtime dhe
Kërkime Shkencore

A. Xhemajli